



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT

Tiranë, më 4.9.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE NR.1, DATË 26.7.2018 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN
NR.109/2017 “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”**

I. Baza ligjore.

Rishikimi i buxhetit në mes të vitit buxhetor është një instrument ligjor dhe praktikë e konsoliduar ndër vite, i cili mbështetet në:

- nenin 160 të Kushtetutës ;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të Rregullores së Kuvendit.

II. Qëllimi, nevoja dhe rëndësia e aktit normativ.

Akti normativ i Këshillit të Ministrave nr.1, datë 26.7.2018 “Për disa ndryshime në ligjin nr.109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018” synon të pasqyrojë, në ligjin e buxhetit vjetor, ndryshimet e ndodhura në ekonominë e vendit për 6-mujorin e parë dhe pritshmëritë për realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e buxhetorë deri në fund të vitit, duke respektuar politikat dhe treguesit e parashikuar në:

- Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020;
- Programin Ekonomik dhe Fiskal 2018-2020, të hartuar dhe rishikuar në bazë të konsultimeve me Fondin Monetar Ndërkombëtar;
- Kuadrin makroekonomik e fiskal afatmesëm.

Objektivat kryesore të aktit normativ janë:

- Alokimi i burimeve drejt projekteve të investimeve publike që kanë pasur ecuri të mirë, për të arritur nivelin e programuar të tyre për vitin 2018;
- Rialokimi i fondeve midis institucioneve buxhetore, për të mundësuar shlyerjen në afat të detyrimeve kontraktore dhe për të reduktuar mundësinë për krijimin e detyrimeve të prapambetura;
- Sigurimi i një fondi për shpërblimin e pensionistëve dhe familjeve në nevojë në fund të vitit.

Ndryshimi i buxhetit të vitit 2018, nëpërmjet këtij akti normativ, ka një rol shumë të rëndësishëm, pasi ndikon në rritjen e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike, rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit, nxitjen e zhvillimit të sektorëve prioritarë të ekonomisë dhe mbështetjen e shtresave në nevojë. Ndryshimet buxhetore nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, duke ruajtur deficitin buxhetor në nivele të pandryshueshme. Këto ndryshime synojnë stimulimin e rritjes ekonomike dhe forcimin e qëndrueshmërisë fiskale të vendit.

Paraqitja e ndryshimeve buxhetore me akt normativ të Këshillit të Ministrave është një praktikë e ndjekur prej vitesh, e cila bazohet në nenin 101 të Kushtetutës dhe në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese. Kriteret për nxjerrjen e akteve normative janë nevoja, urgjenca dhe përkohshmëria e masave të propozuara. Në rastin konkret, ndryshimet buxhetore janë të nevojshme dhe urgjente, për të krijuar mundësinë që investimet apo shpenzimet e tjera të realizohen sipas parashikimeve, duke respektuar afatet dhe procedurat për kryerjen e prokurimeve publike. Përkohshmëria e masave të propozuara argumentohet me faktin që ato marrin fuqi brenda 45 ditëve, pra brenda datës 9 shtator 2018, kur Kuvendi duhet të miratojë me ligj aktin normativ. Gjithashtu, mënyra e ndërhyrjes me akt normativ është në përputhje me nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit në rast se miratimi i ndryshimeve në buxhet nuk bëhet brenda muajit korrik, atëherë propozimi për ndryshimin e ligjit të buxhetit vjetor votohet me procedurë të përshpejtuar.

III. Zhvillimet ekonomike në Shqipëri.

III.1. Vlerësimi i institucioneve financiare ndërkombëtare.

Të gjitha institucionet ndërkombëtare që monitorojnë ekonominë e vendit tonë, si Komisioni European, FMN, Banka Botërore dhe agjencitë e ndryshme ndërkombëtare kanë vlerësuar se ekonomia shqiptare, që prej vitit 2014 e deri në vitin 2018, ka vijuar ecurinë pozitive dhe trendin përshpejtues të rritjes ekonomike, trend i cili pritet të vijojë edhe në periudhën afatmesme. Në disa vlerësime periodike të tyre, të muajve të fundit, theksohet se:

Fondi Monetar Ndërkombëtar, pas mbikëqyrjes së parë të programit me vendin tonë, maj 2018, vlerësoi se ekonomia shqiptare ka vijuar të forcohet, duke arritur rritjen më të lartë ekonomike pas Kosovës për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo rritje reflekton kërkesën e fortë vendase, të nxitur nga një ringjallje në ndërtim, rimëkëmbje në tregun e punës, kredi për ekonomitë familjare dhe

projekte të mëdha të lidhura me investimet e huaja direkte. Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së është reduktuar. Defiçiti i llogarisë korrente u ngushtua, mbështetur nga eksporti i turizmit dhe shërbimeve të tjera.

Standard and Poor's, mbajti të pandryshuar vlerësimin B+, me perspektivë të qëndrueshme, për borxhin sovran të vendit tonë. Kjo kompani vlerësoi se performanca fiskale e vendit është rritur ndjeshëm vitet e fundit, mbështetur nga rritja e qëndrueshme ekonomike dhe një kuadër fiskal i përmirësuar, duke vendosur në ligj kontrollin rigoroz të defiçitit dhe uljen e tij, si dhe risqet e lidhura me të. Performanca në rritje e të ardhurave buxhetore është rezultat i miradministrimit dhe uljes së informalitetit. Shpenzimet janë mbajtur nën kontroll dhe reformat strukturore vijnë, veçanërisht reforma në drejtësi. Rritja ekonomike përgjatë tri viteve të ardhshme pritet të jetë e qëndrueshme dhe do të nxitet nga investimet dhe rritja e eksporteve, kryesisht eksporti i shërbimeve. Konsolidimi fiskal vijon. Performanca fiskale e Shqipërisë vlerësohet të mbetet pozitive deri në vitin 2021 dhe më e mirë se e vendeve me renditje të ngjashme, e mbështetur nga pritshmëritë pozitive të rritjes ekonomike dhe kontrollit të financave publike.

III.2. Situata e përgjithshme financiare për periudhën janar-korrik 2018.

Zhvillimet kryesore makroekonomike.

Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 4.45% në tremujorin e parë, nga 3.8 për qind që ishte në vitin 2017. Nga këndvështrimi sektorial, zgjerimi i aktivitetit ekonomik u mbështet kryesisht nga rritja e sektorit industrial dhe, në veçanti, nga rritja e prodhimit dhe eksportit të energjisë elektrike, në përgjigje të kushteve të mira hidrike. Ritme të larta zhvillimi janë vërejtur në sektorin e turizmit, ku vërehet përmirësim i formalizimit dhe rritje e cilësisë së shërbimeve. Nga këndvështrimi i kërkesës agregate, rritja ekonomike u ndihmua nga zgjerimi i konsumit, investimeve dhe eksportit të mallrave e shërbimeve. Kërkesa e huaj kontribuoi negativisht në rritjen e PBB, për shkak të peshës së lartë të importeve. Politika fiskale vijoi të mbetet në kahun konsolidues. Të dhënat e tërthorta vlerësojnë se këto tendenca zhvillimi janë mbartur edhe në tremujorin e dytë. Rritja ekonomike vijon të mbështetet nga një ambient i brendshëm monetar dhe financiar stimulues, nga rritja e punësimit, përmirësimi i besimit, si dhe nga pritshmëritë për zgjerimin e kërkesës së huaj.

Zhvillimi me trend pozitiv i ekonomisë kontribuoi në rritjen e inflacionit drejt nivelit të targetuar. Inflacioni mesatar i tremujorit të dytë regjistroi vlerën 2.2 për qind, duke ardhur në rritje nga norma mesatare prej 1.9 për qind e tremujorit të parë. Në veçanti, inflacioni shënoi vlerën 2.4% në muajin qershor dhe 2.3 për qind në muajin korrik. Inflacioni mesatar për 6 mujorin e parë ishte 2.1 për qind. Rritja e inflacionit në tremujorin e dytë pasqyroi efektin rezultat të dy goditjeve të kahut të kundërt: Nga njëra anë, rritja e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare solli rritjen e kostove të prodhimit dhe ushtroi një ndikim rritës në inflacion. Nga ana tjetër, forcimi i kursit të këmbimit frenoi përcjelljen e presioneve të huaja inflacioniste në tregun vendas. Faktori i parë ka pasur një intensitet më të fortë veprimi në tremujorin e dytë, por efekti i tij vlerësohet të jetë më i shkurtër në kohë.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik gjatë 3-mujorit të parë u shoqërua me rritjen e punësimit dhe rënien në 12.5% të normës së papunësisë, nga 13.6 për qind që ishte në fund të vitit 2017. Kjo normë përbën nivelin më të ulët historik të papunësisë të regjistruar në Shqipëri dhe sugjeron një përdorim

gjithnjë e më të plotë të kapaciteteve prodhuese në vend. Punësimi për popullsinë 15-64 vjeç u zgjerua me 3.8 për qind. Paga reale mesatare u rrit me 2.3% në tremujorin e parë, çka përbën një premisë pozitive për forcimin gradual të presioneve të brendshme inflacioniste.

Zhvillim i rëndësishëm u arrit në fluksin e investimeve të huaja direkte, të cilat në 3-mujorin e dytë 2018 u zgjeruan me rreth 62 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, duke rezultuar mbi pritshmëritë fillestare, të cilat merrnin në konsideratë ngadalësimin e fazës ndërtuese të dy projekteve të mëdha, TAP-it dhe Hidrocentralit të Devollit.

Perceptimi i agjentëve ekonomikë mbi ekonominë u përmirësua më tej për 6-mujorin e parë të vitit 2018, duke qëndruar mbi mesataren afatgjatë që prej 3-mujorit të dytë 2016.

Për periudhën janar-korrik 2018, krahasuar me një vit më parë, eksportet e mallrave u rritën me 16,8 për qind, ndërsa importet e mallrave u rritën me 4,8 për qind. Defiçiti tregtar arriti vlerën 182 miliardë lekë, duke u reduktuar me 5 për qind krahasuar me vitin 2017.

Zhvillimet kryesore fiskale.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit, për periudhën 7-mujore, arritën rreth 256 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 96.9 për qind në krahasim me planin. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura janë rritur me 7.3 miliardë lekë ose 2.9 pikë përqindje.

Të ardhurat tatimore përbëjnë rreth 93.6 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 98.6 për qind në krahasim me planin. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura janë rritur me 8.9 miliardë lekë ose 3.8 pikë përqindje.

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat përbëjnë 67.3 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 95.2 për qind në krahasim me planin. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura u rritën me rreth 4 miliardë lekë ose 2.4 pikë përqindje.

Në rezultatin e të ardhurave tatimore e doganore kanë ndikuar pozitivisht dhe negativisht këta faktorë:

- Përsheptimi i rritjes ekonomike ndikoi pozitivisht në të ardhurat nga sistemi tatimor.
- Rritja e numrit të të punësuarve, si rezultat i situatës pozitive ekonomike, thellimit të luftës kundër informalitetit dhe rritjes së formalizimit në tregun e punës, ndikoi pozitivisht në vetëdeklarimin e punëmarrësve dhe sigurimin e të punësuarve. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore u rritën me 8.7 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.
- Rritja e importit të karburantit dhe rënia e kursit të këmbimit të monedhave të huaja (euro dhe USD), kundrejt monedhës vendase, ka dhënë ndikime të ndjeshme në reduktimin e të ardhurave nga TVSH për të gjitha kategoritë e mallrave të importuara. Efekti i llogaritur

nga ndryshimet e kursit të këmbimit në 6-mujorin e parë është 4 miliardë lekë TVSH. Rimbursimi i TVSH është rreth 8 miliardë lekë ose 1.4 miliardë lekë më shumë se 7-mujori i vitit 2017.

- Kriza energjitike e vitit të mëparshëm, që detyroi ndërmarrjet e sistemit energjitik, KESH dhe OSHE të importojnë sasi të mëdha të energjisë elektrike, me kosto më të lartë se energjia e prodhuar në vend, ndikoi negativisht në rezultatin financiar të tyre dhe në kontributin fiskal në buxhet, e cila u reflektua në vitin 2018, pas depozitimit të bilancit. Kjo situatë pritet të përmirësohet këtë vit, si rezultat i rritjes së sasisë së prodhimit të energjisë elektrike në vend dhe kufizimit të ndjeshëm të importeve, që do të sjellë përmirësimin e treguesve ekonomikë të ndërmarrjeve të sistemit energjitik.
- Reduktimi në nivele minimale i normave të interesit, i cili ndikoi në reduktimin e të ardhurave nga dividendi, tatimi mbi interesat e depozitave të kursimit dhe bonove të thesarit, duke ndikuar negativisht në tatimin mbi të ardhurat.
- Rritja me 19.7 për qind e të ardhurave nga renta minerare në eksport, si rezultat i rritjes së sasisë së naftës bruto të eksportuar dhe rritjes së çmimit të këtij produkti në tregjet ndërkombëtare.

Të ardhurat nga pushteti vendor u realizuan në masën 116.2 për qind, me një tejkalim prej 1.7 miliardë lekësh në krahasim me planin. Në këtë tejkalim kanë ndikuar pozitivisht të ardhurat nga taksat lokale me 3.1 miliardë lekë dhe tatimi mbi biznesin e vogël me 0.1 miliardë lekë.

Të ardhurat nga fondet speciale u realizuan në masën 106.5 për qind në krahasim me planin, me një tejkalim prej 3.4 miliardë lekësh. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura u rritën me 4.4 miliardë lekë ose 8.7 pikë përqindje. Ndikimin më të madh në këtë tejkalim e kanë dhënë të ardhurat nga sigurimet shoqërore.

Të ardhurat jotatimore u realizuan në masën 88.8 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto të ardhura u rritën me 0.6 miliardë lekë ose 4.7 pikë përqindje.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për periudhën 7-mujore, arritën nivelin 252.8 miliardë lekë, me një realizim të planit në masën 95.1 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto shpenzime u rritën me 5.4 miliardë lekë ose 2.2 pikë përqindje. Nga këto:

- ***Shpenzimet korrente*** përbëjnë rreth 86.3 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Në krahasim me planin, këto shpenzime u realizuan në masën 97 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, shpenzimet korrente u rritën me 4.7 miliardë lekë ose 2.2 pikë përqindje.
- ***Shpenzimet kapitale*** përbëjnë rreth 13.7 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Në krahasim me planin, këto shpenzime u realizuan në masën 88.3 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, këto shpenzime u rritën me 3.4 miliardë lekë ose 12.6 pikë përqindje.

Për periudhën janar-korrik 2018, si rrjedhojë e rezultatit të arritur në të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, u arrit që nga 1.6 miliardë lekë deficit buxhetor i planifikuar, fakti rezulton me 3.1 miliardë lekë sufiçit buxhetor.

IV. Ndryshimi i buxhetit me akt normativ.

Akti normativ përmban këto ndryshime në ligjin ekzistues:

Së pari, ruhen të pandryshuar treguesit kryesorë të buxhetit të parashikuar në fillim të vitit.

Defiçiti buxhetor mbetet i pandryshuar, po kështu edhe totali i të ardhurave dhe shpenzimeve të përgjithshme. Ndryshimet konsistojnë në disa rialokime midis zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat nuk japin efekt në totalin e tyre.

Së dyti, bëhen disa rialokime brënda zërave të shpenzimeve të buxhetit, si më poshtë:

- Miratohet një fond për shpërblimin e pensionistëve dhe familjeve në nevojë, për t'u akorduar në fund të vitit, si rezultat i kursimeve nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe parashikohet rritja e të ardhurave në këto skema.
- Rialokohen shpenzimet kapitale, të cilat përmbajnë:
 - Rialokime nga projektet me ecuri të ngadaltë, tek ato me ecuri të lartë, për të mbështetur avancimin e projekteve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe arsimit profesional.
 - Mbështetje për sektorin energjitik, nëpërmjet rritjes me 1.5 miliardë lekë të financimit të huaj.
 - Mbështetje për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve në shumën 1 miliardë lekë.
- Bëhen disa rialokime midis zërave të shpenzimeve korrente dhe kapitale për të akomoduar nevojat për inceleratorin e Tiranës.
- Bëhen disa rialokime midis zërave të shpenzimeve të personelit, për të akomoduar nevojat e Gardës së Republikës dhe Polidisë së Shtetit.
- Sigurohet mbështetje për familjet që përfitojnë nga bonusi i strehimit, nëpërmjet rialokimeve të brendshme midis zërave të shpenzimeve buxhetore të programit të strehimit.
- Reduktohet me 300 milionë lekë pagesa e papunësisë, si rezultat i daljes nga kjo semë e një numri të konsiderueshëm të papunësh.
- Bëhen ndryshime në numrin e punonjësve, pa efekte financiare në buxhet.

V. Vlerësimi i Komisionit.

Gjatë diskutimit në Komision, deputetët paraqitën këto vlerësime për situatën ekonomike e financiare të vendit dhe për aktin normativ të buxhetit:

1. Gjatë vitit 2018 ekonomia e vendit vijoi tendencën në rritje, tendencë e cila ka nisur në vitin 2014. Rritja ekonomike për 3-mujorin e parë ishte më e lartë se parashikimet në fillim të vitit dhe vlerësimet e parashikimet janë për ritëm të lartë gjatë gjithë vitit 2018. Ritmi i lartë i rritjes, i cili është ndër më të lartit në rajon, parashikohet të vijojë edhe në periudhën afatmesme. Kjo rritje u mbështet kryesisht nga rritja e sektorit industrial, veçanërisht nga prodhimi dhe eksporti i energjisë elektrike, rigjallërimi i sektorit të ndërtimit dhe ritmet e larta të zhvillimit të sektorit turizmit. Nga pikëpamja e kërkesës agregate, rritja ekonomike u mbështet nga zgjerimi i konsumit, investimeve dhe eksportit të mallrave e shërbimeve. Ritme të larta u arritën në investimet e huaja direkte.

Ritmi i lartë i rritjes ekonomike kontribuoi në rritjen e inflacionit drejt nivelit të targetuar, rritjen e punësimit dhe reduktimin e normës së papunësisë. Rritja shumë e lartë e eksportit, krahasuar me importin, ndikoi në ngushtimin e defiçitit të llogarisë korrente.

Rritja ekonomike u shoqërua me forcimin e qëndrueshmërisë fiskale të vendit. Për periudhën janar-korrik 2018, nga 1.6 miliardë lekë deficit buxhetor i planifikuar, rezultati ishte 3.1 miliardë lekë sufiçit buxhetor.

2. Ndryshimet buxhetore, të parashikuara me akt normativ, janë të domosdoshme, pasi synojnë garantimin e shpërblimit të pensionistëve dhe shtresave në nevojë, rritjen e efijencës së përdorimit të burimeve publike dhe rritjen e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit. Nëpërmjet rialokimeve në investime, synohet përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të energjisë elektrike, si dhe avancimi i projekteve të fushës së ujësjellës-kanalizimeve dhe arsimit profesional. Gjithashtu, ndryshimet buxhetore sigurojnë mbështetje financiare për personelin e disa institucioneve të rëndësishme, siç janë Garda e Republikës dhe Policia e Shtetit.

3. Ndryshimet e buxhetit nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë, të parashikuar në fillim të vitit: defiçiti buxhetor mbetet 2 për qind e PBB, balanca primare pozitive mbetet 0.6 për qind e PBB dhe balanca korrente fiskale 3.3 për qind e PBB, e cila pritët të përmirësohet më tej, si rrjedhojë e investimeve më të larta dhe e mbajtjes së pandryshuar të defiçitit buxhetor.

4. Prioritet për pjesën e mbetur të vitit mbetet vijimi dhe thellimi i reformave strukturore në fusha të përcaktuara si prioritare, si reforma në energji, në menaxhimin e financave publike dhe në drejtësi. Reformat në sektorin e energjisë duhet të synojnë përmirësimin e qeverisjes dhe ristrukturimin financiar të sektorit shtetëror të energjisë elektrike. Reformat në sektorin e turizmit duhet të mbështeten në plane e programe të studiuar mirë, për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori.

5. Të gjitha institucionet publike, qendrore e vendore, duhet të rrisin përpjekjet për të arritur një performancë më të mirë, e cila ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorëve apo zonave të ndryshme të vendit, si dhe zbutjen e pabarazive në të ardhurat dhe nivelin e jetesës së qytetarëve.

6. Masat për përmirësimin e administrimit tatimor duhet të vijojnë më tej, nëpërmjet fuqizimit të vazhdueshëm të institucioneve fiskale dhe forcimit të menaxhimit financiar e kontrollit nga këto struktura. Puna e vazhdueshme në këtë drejtim do të ndikojë në zgjerimin e bazës tatimore, reduktimin e informalitetit e evazionit fiskal dhe rritjen e të ardhurave të buxhetit e, rrjedhimisht, në forcimin e konsolidimit fiskal.

7. Rritja e efikasitetit të shpenzimeve është një prioritet tjetër i rëndësishëm. Në këtë kuadër, të gjitha institucionet buxhetore duhet të rrisin përpjekjet për përmirësimin e menaxhimit të fondeve buxhetore, duke i dhënë përparësi vlerësimit dhe monitorimit më të mirë të projekteve të investimeve publike me financim të brendshëm dhe të huaj.

8. Për forcimin e mëtijshëm të konsolidimit fiskal, krahas masave për rritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve, duhet të vijojnë më tej masat për përmirësimin e menaxhimit të borxhit publik, i cili duhet të fokusohet në zgjatjen e maturitetit të borxhit dhe diversifikimin e bazës së investitorëve, duke shmangur risqet e mundshme të huamarrjes.

9. Masat për regjistrimin e detyrimeve të papaguara, në kuadër të projekteve të investimeve publike, si dhe për rimbursimin e TVSH, duhet të vijojnë e thellohen. Forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë drejtim dhe zgjerimi i sistemit IT të thesarit në qeverisjen vendore duhet të synojë regjistrimin e të gjitha detyrimeve të papaguara.

10. Mbështetja e shtresave në nevojë mbetet një prioritet tjetër i rëndësishëm jo vetëm për këtë vit, por edhe në të ardhmen.

VI. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e sipërcituara, Komisioni e miratoi aktin normativ të Këshillit të Ministrave me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm në mbledhje.

RELATORI

Anastas ANGJELI

KRYETARI

Erion BRAÇE